



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1715 / 5 prot.

Tiranë më 13.12.2021

REKOMANDIM

Nr. 63, datë 13.12.2021

PËR KONTROLLUESIN UNIVERSITETI I TIRANËS, FAKULTETI I
GJUHËVE TË HUAJA

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.154, datë 14.10.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), si dhe në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 03.06.2021 “Për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020”, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi në kuadër të zhvillimit të procesit mësimor pa ndërprerje në kushtet e situatës së diktuar për shkak të pandemisë Covid-19, ka implementuar platformën e

unifikuar me administrim të qendëruar Microsoft Teams 365 Education. Gjatë vitit kalendarik mësimor 2020-2021, është zhvilluar mësimdhënie në distancë (online) nëpërmjet kësaj platforme.

Platforma Microsoft Teams 365 Education (shoqëruar me modulet funksionale përkatëse për realizimin e të gjitha proceseve akademike por edhe administrative) ofron shërbime të tilla si: krijimi i përdoruesve dhe pajisja e tyre me kredencialet e aksesimit të saj ("*emër përdoruesi*" dhe "*fjalëkalim*"), krijimi i grupeve/klasave, mundësi komunikimi në grup ose privatisht midis përdoruesve, kalendar aktivitetesh, përdorim i aplikacioneve Office online, komunikim/transferim dokumentesh, ruajtje dokumentesh në "*cloud*", video-konferenca në grup, mundësi regjistrimi të video-konferencës dhe ruajtje në cloud, zhvillimi i provimeve dhe vlerësimi i studentëve, planifikime veprimtarish të tjera mësimore, krijimi i postës elektronike/e-mail, etj.

Kontrolluesi ka krijuar fillimisht rolet e përdoruesve: administrator, pedagog, student dhe më pas i ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike të aksesojnë platformën sipas llogarisë së personalizuar duke kujtuar gjithashtu që të ndërrojnë fjalëkalimin përkatës.

Pedagogu ka mundësi të krijojë klasën e vet sipas lëndës për të cilën është titullar dhe shtojë studentët sipas emrave referencë të disponuar nga sekretaria mësimore.

Studentët informohen nëpërmjet e-mailit në lidhje me klasën e krijuar, datat dhe orën e zhvillimit të mësimit. Në datën dhe orën e mësimit, studentët kanë mundësi ta aksesojnë platformën në mënyrë anonime ose nëpërmjet llogarisë së tyre.

Kategoritë e subjekteve të të dhënave (student) përdorin këtë platformë duke u shfaqur me pamje, pa u informuar më parë nëse përpunimi i të dhënave personale "*imazhe-video*" nëpërmjet kësaj platforme është i detyrueshëm apo vullnetar, qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Nga verifikimi në faqen zyrtare <https://fgjh-ut.edu.al> të fakultetit, rezultoi se nuk ekziston ndonjë informacion, lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, për qëllim të zhvillimit të mësimit në distancë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmëshja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasojat të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, gjatë procesit të përpunimit të të dhënave "*imazhe-video*" për këtë kategori subjektësh, **Kontrolluesi nuk ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave**

personale lidhur me mjaftueshmërinë e të dhënave personale, sanksionuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, në të cilin parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen thellësisht me qëllimin specifik të përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kontrolluesi ka detyrim të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale lidhur me mjaftueshmërinë e tyre. Kontrolluesi duhet të kufizohet vetëm në ato të dhëna të cilat lidhen thellësisht me qëllimin specifik të përpunimit, sanksionuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit.

2. Kontrolluesi ka lidhur kontratë bashkëpunimi më shoqërinë “Soft Solution SHPK”. Konstatohet se, në kontratë nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) deklarin në rubrikën 1.2, të formularit të njoftimit “personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti”;
- (ii) deklarin në rubrikën 4, “kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”;
- (iii) deklarin në rubrikën 5, “Të dhënave sensitive që përpunohen”;
- (iv) deklarin në rubrikën 6, “Qëllimi i përpunimit”;
- (v) deklarin në rubrikën 7, “Subjekti marrës dhe qëllimi përhapjes”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

4. Kontrolluesi, mbledh dhe ruan të dhëna të studentëve të cilët janë vaksinuar, kanë kryer testet PCR, apo tamponët për diagnostikimin me Covid-19, testet e studentëve, ruhen nga departamenti i degëve përkatëse, ku studenti studion. Kontrolluesi nuk ka saktësuar një strukturë se ku do të ruhen këto të dhëna, kohën e ruajtjes së të dhënave, formën e mbajtjes së tyre si dhe aksesin në to, për të përcaktuar personat përgjegjës, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Kontrolluesi ka hartuar “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” por, përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon, si dhe kategorive të subjekteve të të dhënave (deklaruar në “Formularin e Njoftimit”), në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri.

Kontrolluesi, çdo rregullore të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit (me përjashtim të Rregullores “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja”), ishte nga Rektorati dhe pasqyronte situatën në këtë strukturë dhe jo gjendjen aktuale të Kontrolluesit, i cili ka të tjera kushte dhe sistem për sigurinë e të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive. Këto të dhëna duhet të mbahen të ndara në mënyrë që mos të lejojnë një konsultim të padëshiruar gjatë aktivitetit të zakonshëm administrativ.

5. Kontrolluesi nuk ka hartuar apo nënshkruar “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, si staf akademik dhe personel administrativ, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “Deklaratës së Konfidencialitetit”, është që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull “Deklaratë Konfidencialiteti”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave

personale” punëmarrësit informohen mbi përgjegjësitë në rast përhapje në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr.47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancë dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, janë paraqitur përfaqësuesit e Rektoratit dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të cilët parashtruan pretendimet e tyre me shkrim, në lidhje me shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Sa i përket konstatimit në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave sipas parashikimit të nenit 18 të Ligjit, kontrolluesi argumenton se përfundimi i nxjerrë nga grupi i kontrollit nuk qëndron pasi e gjithë veprimtaria e Universitetit të Tiranës, për zhvillimin e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve, është bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", Statutit dhe Rregullores së UT-së, Rregullores së Brendshme të Universitetit të Tiranës "Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19", Vendim i Senatit Akademik datë 21.10.2020, për përdorimin e unifikuar të sistemit digjital të mësimin në distancë, platformës Microsoft Teams pasi zhvillimi i procesit mësimor në distancë u kushtëzua nga virusi Covid-19; Udhëzues i Universitetit të Tiranës për zhvillimin e mësimin në distancë; Rregullore e posaçme e Universitetit

të Tiranës mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2020-2021 dhe akteve të tjera.

Referuar argumentimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i studentëve në lidhje me mësimdhënien në distancë (online) nëpërmjet njoftimeve dhe akteve rregullatore (në lidhje me këtë proces) të miratuara nga Rektori, Senati i Universitetit të Tiranës dhe institucione të tjera politikë-bërëse, është në funksion të proceseve të punës por i pamjaftueshëm për të informuar subjektet e të dhënave mbi të drejtat që ata kanë sipas dispozitave të parashikuara në nenin 18 të Ligjit, në rastin kur Kontrolluesi përpunon të dhëna personale të tyre. Informimi ka për qëllim që subjekti i të dhënave, të njihet me të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjimin e të dhënave të tij, në rast se konstaton se ato janë të pasakta.

- Sa i përket konstatimit në lidhje kontratat me të tretët, Kontrolluesi argumenton se Kontrata e FGJH-se të Universitetit të Tiranës dhe "Soft Solution" SHPK të cilës i referoheni është një kontratë shërbimi që i ka përfunduar afati më 22.07.2020, ndaj nuk mund të nxirren përfundime mbi një akti juridik, efektet juridike e të cilit kanë qenë të përfunduara në momentin e inspektimit.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit këtë kontratë shërbimi, të cilës i kishte përfunduar afati më 22.07.2020 si dhe kanë deklaruar se kontrata e re do të jetë një përsëritje e të njëjtës kontratë. Kontrolluesi vetëm gjatë seancës dëgjimore ka paraqitur një kontratë të re nga shqyrtimi i të cilës rezulton se në këtë kontratë ka përfshirë detyrimet ligjore të cilat mungonin në kontratën e parë.

- Lidhur me konstatimin e përditësimit të "*Formularit të Njoftimit*" Kontrolluesi ka paraqitur formularin e njoftimit të përditësuar pas përfundimit të hetimit administrativ.
- Sa i përket konstatimit në lidhje me pikën e katërt, Kontrolluesi argumenton se Universiteti i Tiranës përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit ku njësi kryesore janë fakultetet dhe institutet e kërkimit shkencor. Rregulloret janë të vlefshme dhe zbatohen nga të gjitha strukturat e Universitetit të Tiranës.

Kontrolluesi argumenton se nuk qëndrojnë konstatimet e grupit të kontrollit për arsye se ka marrë masat për zhvillimin e procesit mësimor në zbatim të urdhrit të MASR, për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve të cilët janë vaksinuar, kanë kryer testet PCR, apo tamponët për diagnostikimin me Covid-19, që janë sekretaret e departamenteve përkatëse pasi ato janë struktura që mbajnë çdo informacion në lidhje me studentet dhe kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale të tyre, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në rregulloren "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës*" si dhe konform Udhëzimit nr.7, datë 09.06.2010, të

Komisionerit "*Për përpunimin e të dhënave personale në institucionet e arsimit të lartë*".

Zyra e Komisionerit vlerëson se, rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive. Këto të dhëna duhet të mbahen të ndara në mënyrë që mos të lejojnë një konsultim të padëshiruar gjatë aktivitetit të zakonshëm administrativ.

- Sa i përket konstatimit në lidhje me pikën e gjashtë Kontrolluesi argumenton se konstatimet e grupit të inspektimit nuk qëndrojnë sepse nga ana e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja atyre u janë vënë në dispozicion të gjitha informacionet mbi procesin e implementimit të platformës Microsoft Office 365 education për Universitetin e Tiranës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Efektet e përhapjes së virusit COVID-19 dhe pasojat e rënda të saj në shëndetin dhe jetën e qytetarëve kanë bërë që ofrimi i shërbimeve nëpërmjet platformave TIK të mos jetë një nga alternativat për akses, por thuajse e vetmja alternativë për këtë qëllim.

Një rol kryesor dhe veçanërisht të rëndësishëm gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ka luajtur platforma Microsoft 365 Educations, e përzgjedhur nga institucionet akademike në aspekt dhe si një alternativë për mësimdhënien online. Kësisoj, platformat TIK janë aktualisht dhe, sipas të gjitha gjasave, do të vijojnë të jenë edhe në të ardhmen, një domosdoshmëri dhe një zgjidhje e arsyeshme veçanërisht për Institucionet e Arsimit të Lartë, për zhvillimin e mësimin dhe provimeve online, si një masë paraprake për të mbrojtur jetën e qytetarëve nga virusi COVID-19.

Nga ana tjetër, studentëve dhe pedagogëve, krahas garantimit të së drejtës për zhvillimin e ciklit akademik, duhet t'ju garantohet edhe pacënueshmëria e të drejtave të tyre për mbrojtje të të dhënave personale dhe jetës private, në kuadër të përdorimit të platformave TIK gjatë dhe në vijim të zhvillimit të mësimin dhe provimeve online.

Kjo nënkupton detyrimin e Kontrolluesve publikë për t'i kushtuar një vëmendje të posaçme marrjes së masave tekniko-organizative dhe krijimit të kushteve të nevojshme për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve në përputhje me kriteret ligjore për përpunimin e tyre, si dhe bashkë me të, ruajtjen e konfidencialitetit në përputhje me parashikimet e neneve 27 dhe 28 të Ligjit si dhe dispozitave të akteve nënligjore të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe angazhimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 pika 1, germa "a/l", si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të rishikojë procesin e përpunimit të të dhënave personale gjatë zhvillimit të mësimdhënies në distancë (online) në mënyrë që përpunimi mos të jetë në tejkallim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ndërmarrë hapa konkrete për informimin specifik të subjekteve të të dhënave në lidhje me proceset përpunuese sipas elementeve të evidentuara, si dhe të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimi të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të miratuar nga Komisioneri;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;

5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2;
 - (iii) vazhdimisht detyrimet e përcaktuara në pikat 3, dhe 4;
 - (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 5;
 - (v) brenda 45 (dyzetepesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më __. __. 2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

